



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU KOSOVO COMPETITION AUTHORITY
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. <u>430/23-11/B</u>
Nr. i Fq./Br. St./No. Pg. <u>1/4</u>
Data/Datum/Date: <u>08-09-2023</u>

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr. 85/2023

Datë: 08.09.2023

Në bazë të nenit 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27, 34, 35, 39 dhe 55 par 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012. Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant. Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë; 01.08.2023, me Nr. Prot. 353/23-01/H ka pranuar kërkesën për Përqendrim të Përqendrimit lidhur me blerjen e aksioneve nga Nelt Co d.o.o., Beograd mbi D Way d.o.o., Beograd dhe Neregelia d.o.o., Podgoricë mbi D Way Podgoricë dhe Prelimio Holding Limited (shitësi).

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 08.09.2023, mori këtë vendim;

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve, lidhur me blerjen e aksioneve nga Nelt Co d.o.o., Beograd mbi D Way d.o.o., Beograd dhe Neregelia d.o.o., Podgoricë mbi D Way d.o.o., Podgoricë.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje më nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja tre mijë Euro.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 01.08.2023, me Nr. Prot. 353/23-01/H ka pranuar kërkesën për Përqendrim të Përqendrimit lidhur me blerjen e aksioneve nga Nelt Co d.o.o., Beograd mbi D Way d.o.o., Beograd dhe Neregelia d.o.o., mbi D Way d.o.o Podgoricë. Prelimio Holding Limited (shitësi).

Palët në Përqendrim

Nelt Co d.o.o., Beograd, si blerës vepron brenda grupit Nelt, me adresë në 226b Marsal Tita, 11272 Dobanovic, Republika e Serbisë, me numër të biznesit 17304712.

Nelt është 100% në pronësi të Neregelia Trading Limited, me seli në Griva Digeni, Panayides 2/3 3030 Limassol, Qipro dhe numër të regjistrimit të biznesit HE95511.

Grupi Nelt merret kryesisht me shpërndarjen e mallrave të konsumit, duke ofruar edhe shërbime të tjera si shpërndarjen e produkteve farmaceutike, brokerime, llogjistikë doganore dhe në industrin e mishit.

Neregelia d.o.o., Podgoricë, është pjesë e grupit Nelt, e cila është në 100% në pronësi të Neregelia Trading Limited, me adresë në Cetinjski put bb, 81000, Mali i Zi. Grupi Nelt shpërndan produkte të prodhuesve të njohur duke përfshirë; Procer & Gamble, Dr. Oetker, Jakobs, Mars, Reckitt, Benckiser, Johnson & Jonson.

Grupi Nelt ka filiale të regjistruar në Kosovë. **Nelt L.L.C.**, me adresë në Rr. Sadik Shala nr. 146 14000, Lipjan, Kosovë, me numër të regjistrimit të biznesit 810712671. Nelt Kosovë është 51% në pronësi të Neregelia Trading Limited, dhe 49% në pronësi të Beta Group. Nelt L.L.C., është i specializuar në shpërndarjen e mallrave të konsumit dhe produkteve farmaceutike. Rrjeti i saj furnizon mbi 2000 pika shitjesh me një portofol të gjerë të markave ndërkombëtare.

Prelimio Holding Limited, si shitës është kompani me seli në Qipro, me adresë të regjistruar në Griva Digeni, Panayides 2/3 3030 Limassol, Qipro dhe numër të regjistrimit të biznesit HE95511.

D Way d.o.o., Serbi, (targeti 1), me adresë në 226b Marsal Tita, 11272 Dobanovic, Republika e Serbisë, me numër të biznesit 21399353. Kompani është 100% në pronësi të Prelimio Holding Limited,

D Way CG, Podgoricë, (targeti 2), me adresë në Cetinjski put bb, 81000, Mali i Zi, me numër të biznesit 50843020. Kompani është 100% në pronësi të Prelimio Holding Limited,

Baza Ligjore

Sipas nenit 13, të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i njërës palë në Përqendrim (tregun e brendshëm e kalon shumë 1,000,000 Euro.
- c) Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen për blerjen e aksioneve të lidhur me datë 21 Korrik 2023.
- d) Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve, datë 21.07.2023.

- e) Kërkesa për përqendrim, është bërë për arsye se Aplikuesit janë ndërmarrje e lidhur dhe pjesë përbërëse e kompanisë Neregelia Holding Limited që ka një filial të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 16.08.2023
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 17.08.2023
4. Më datë 26.06.2023 palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve ndërmjet Nelt Co d.o.o., Neregelia d.o.o., së bashku (blerësit) dhe Prelimio Holding Limited (shitësi) mbi D Way d.o.o, Serbi, D Way d.o.o Podgoricë (targeti).

Analiza e Konkurrencës

Transaksioni i propozuar, ka të bëjë me blerjen e aksioneve të dy filiale njëra në Serbi dhe tjetra në Mal të Zi. Kompanitë janë nën pronësi të njëjtë, pra të ndërmarrjes Prelimion Holding Limited, ndërsa pas mbylljes së transaksionit të dy filialet target do të jenë pjesë e të njëjtit grup shoqëror. Ndërmarrjet target nuk kanë ndonjë prezencë në Kosovë, qoftë ndonjë filiale apo përmes shitjeve, ndërsa palët blerëse kanë një filiale të regjistruar në Kosovë e cila ka një strukturë të tregut prej 0,03%, (e papërfillshme). Tregu për ofrimin e shërbimeve të transportit është treg mjaftë konkurrues pasi ka një numër të madh të kompanive që merren me këto aktivitete të shpërndarjes-transportin e mallrave të konsumit etj. Transaksioni si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës. Transaksioni i propozuar nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues në treg, për më tepër, meqenëse targeti nuk ka prezencë, tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga ky transaksion.

Tregjet Relevante dhe Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu relevant, përcaktimi i tregut relevant mund të lihet i hapur.

Tregu i Produktit, tregu i shpërndarjes dhe shitjes së mallrave të konsumit.

Tregu gjeografik, do të përcaktohet tregu kombëtar.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Kërkesa për Njoftimin e Përqendrimit është bërë për arsye se Aplikuesit Nelt Co d.o.o., dhe Neregelia d.o.o., i përkasin dhe veprojnë mbrenda Grupit Nelt. Neregelia Trading Holding është kompania mëmë, e cila ka në pronësi 51% në filialin Nelt Sh.p.k Kosovë. Sipas vlerësimit të përqendrimit, transaksion nuk do të ketë efekte negative për Konkurrencën e rrjedhshme për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e

ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar se transaksioni nuk paraqet efekte negative, në konkurrencë për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominues të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi

Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva